



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1016_09_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 27.09.2013.

në seancën e mbajtur më datë 20 dhjetor 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për parashtruesin e ankesës Y.M., (shifra e konsumatorit DPR - 123947) nga Fushë Kosova ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1016_09_13 i datës 05.09.2013.

Arsyetim

Konsumatori Y.M. me datë 14.10.2009 ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kërkuar që të bëhet shlyerja e borxhit të papaguar deri në periudhën 06/2007.

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim të njehsorit elektrik me datë 29.08.2012 kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 006859 me gjendje TL= 28912 kW (tarifa e lartë) dhe TU= 73989kW (tarifa e ulët) dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 62253197 me gjendje TL= 00000 kW dhe TU= 00000 kW.

Departamenti për Konsumator në KEK me datë 28.03.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij duke u bazuar në kontratën e shitblerjes së pronës datë 06.06.2007, marrëveshjes mbi shfrytëzimin e pronës nr. 349-2 datë 27.09.1999 si dhe rrjedhës së energjisë.

Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 05.09.2013 ka nxjerr vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që: 1) të shkarkoi nga borxhi i energjisë elektrike shifrën DPR - 123947 e cila evidentohet në emër të D.J. që përfshin periudhën deri me datën e nënshkrimit të kontratës më 06.06.2007; 2). borxhin e krijuar në shifrën DPR – 123947 sipas pikës 1 të këtij vendimi ta kërkoj nga z. Zarko Dimic në përputhje me nenin 5 të kontratës për shitblerjen e pronës Vr.nr.5033/2007 të datës 06.06.2007 përmes procedurës gjyqësore; dhe 3) pas marrjes së veprimeve në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi obligohet që shifrën DPR-123947 ta kaloi nga emri i D. J. në emër të pronarit të ligjshëm të banesës Y.M.



Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 27.09.2013 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se parashtruesi i ankesës përveç një ankese të shitblerjes nuk ka prezantuar asnjë dokument tjetër dhe se nuk është legjitimuar në këtë banesë si shfrytëzuese i banesës, si dhe e tërë evidenca në këtë shifër deri në muajin 06.06.2007 është në emër të D.J. Në ankesë theksohet se në bazë të kontratës së shitblerjes, respektivisht nenit 4 të kontratës shitësi i garanton blerësit se nuk bartë asnjë obligim të më hershëm. Po ashtu në ankesë theksohet se shitësi deri me datën e kontratës nuk i është drejtuar asnjë herë furnizuesit me ndonjë shkresë që të kontestoj borxhin e krijuar nga dikush tjetër, dhe se nuk ka dëshmi që banesa ka qenë e uzurpuar, dhe se për KEK-u nuk ka pasur interes me evidentoj në emrin e krijuesit të shpenzimeve.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20 dhjetor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se pretendimet e KKDFE-së se vendimi është i pabazë pasi që përveç kontratës nuk ka asnjë provë tjetër nuk është i drejtë pasi që pas analizimit të kontratës së shitblerjes së banesës të datës 06.06.2007 e cila kontratë është e lidhur mes të Zarko Miroslav Dimic, nga Fushë Kosova në cilësinë e shitësit të banesës dhe Y.R.M. në cilësinë e blerësit të banesës ka vërejtur se në nenin 5 të kontratës për shitblerjen e pronës theksohet se, të gjitha obligimet të cilat e ngarkojnë banesën deri me datën e nënshkrimit të shitjes së pronës i bart shitësi. PO ashtu duhet theksuar se kjo kontratë është e vërtetuar edhe në Gjykatën Komunale në Prishtinë Vr.nr.5033/2007 me datë 06.06.2007.

Sa i përket pretendimit të KEDS-it se neni 4 i kontratës së shitblerjes i garanton blerësit se bart asnjë obligim të më hershëm, duhet theksuar se edhe në vendimin e DMK të ZRRE-së është theksuar se borxhin e krijuar në shifrën DPR – 123947 deri më datën e kontratës së shitblerjes ta kërkoj përmes procedurës gjyqësore.

Sa i përket pretendimit të KEDS-it se shitësi nuk i është drejtuar furnizuesi për kontestimin e borxhit nga dikush tjetër dhe se nuk ka dëshmi se banesa ka qenë e uzurpuar me çka edhe dyshohet korrektesia e shitësit, duhet theksuar se sipas kontratës së shitblerjes së banesës e cila kontratë është e vërtetuar edhe në gjykatë, pronar legjitim i banesës deri me datë 06.06.2007 ka qenë Zarko Dimic, ndërsa nga data 06.06.2007 pronar legjitim është Y.M., dhe se për këtë edhe në vendim është theksuar se borxhin e krijuar deri me datën e nënshkrimit të kontratës ta kërkoj përmes procedurës gjyqësore. Bordi i ZRRE-së konsideron se mosveprimet e marra nga ana e KEK-ut në atë periudhë kur është krijuar borxhi i energjisë elektrike dhe mos inkasimi i tij nga ana e shfrytëzuesve para lidhjes së kontratës nga konsumatori, nuk mund t'i ngarkohen pronarit të ligjshëm pasi që edhe dispozitat ligjore nuk e lejojnë këtë veprim.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1016_09_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.



- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar